


## 1. Kontekst

QE16 A keni shokë ose njihni dikend I cili...?

Përgjigje: Po



Shpërbërje/Analiza Socio-demografike

Tema: Persona me origjin etnike tjetër nga e juaja

Po %	BE27	MK
Gjithsej	57%	80%

Gjinia		
Mashkull	60%	88%
Femër	54%	73%

1 Moshën		
15-24	71%	85%
25-39	65%	81%
40-54	60%	82%
55 +	42%	75%

Arsimi (nga fundi i)		
15-	41%	65%
16-19	56%	86%
20+	67%	91%
Akoma studion	73%	84%

Rezultatet e këtij hulumtimi ilustrojnë pasurinë multi-kulturore dhe multi-etnike që ekziston në IRJM. Në fakt ka më shumë Maqedonas që njohin njerëz me origjinë të ndryshme etnike apo të fesë, besimeve të ndryshme nga vetë ata apo romë në rrethin e tyre të ngushtë personal se sa fqinjët e tyre Evropian (proporcioni i marrë në IRJM ndryshonte mes 13 dhe 42 pikë). Por një pakicë e vogël e Maqedonasve thonë se ata njohin persona homoseksual (vetëm 6% në krahasim me 38% në BE).


Si në nivel Evropian korrelacioni i moshës (por edhe niveli i arsimit) dhe fakti i njohjes së njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike është shumë i fortë. Të rinjtë e moshës midis 15 dhe 24 dhe njerëzit që kanë studiuar më gjatë janë më të shumtë në njohjen e njerëzve të një prejardhje etnike të ndryshme nga të tyre.

## 2. Perceptioni dhe përvojat nga diskriminimi

QE1 Për çdo lloj të diskriminimit, ju lutem më tregoni, në baz të mendimit tuaj është shumë I përhapur, mjaft I përhapur, mjaft pak ose shumë pak?

Diskriminimi në bazë të...?

Përgjigje: Gjithsej "përhapur"




Popullata Maqedonase konsideron se diskriminimi i bazuar në moshë është më i përhapur në vendin e tyre krahasuar me atë të origjinës etnike dhe paaftësisë. Relativisht me rezultatet Evropiane, Maqedonasit gjithashtu mendojnë se diskriminimi në bazë gjinore është më i zakonshëm sesa në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (4 pikë më shumë sesa mesatarja Evropiane).



## 3. Diskriminimi në punë


QE5 Në (SHTETIN JONË), kur një kompani donë që të punësoj një individ dhe mund të zgjedhë mes dy individ me aftësi të njëta, cilën nga kriteret posht përmendura sipas juve mund ti dëmtojë njërin nga kandidatët?



Vëllimi i përgjigjeve në këtë pyetje është qartë më i ulët se në Bashkimin Evropian. Kjo mund të çojë në të menduarit se kriteret e paraqitura këtu janë më pak relevante për situatën në IRJM. Mosha e aplikuesit për rekrutim/punësim është megjithatë një nga kriteret kryesore që mund të vë një aplikues në disavantazh, para pamjes së tyre fizike apo mënyrës së tyre të veshjes. Ne vërejtëm se ngjyra e lëkurës ose prejardhja etnike apo aftësitë e kufizuara janë cituar rreth gjysmë herë më pak se sa në nivelin Evropian.

## 4. Shumëllojshmëri në medime

QE11 A mendoni se diverziteti në mënyrë të mjaftueshme është i reflektuar ne media, duke marrë parasysh...?




Për shumicën e Maqedonasve (dhe në një përqindje të ngjashme të nivelit Evropian) diversiteti në aspektin e përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, fesë dhe aftësisë së kufizuar është i përfaqësuar aq sa duhet në mediat kombëtare. Shënimi i vetëm më i ulët: orientimit seksual për të cilin situata në IRJM duket më pak e kënaqshme se sa në shtetet anëtare në përgjithësi. Ne vërejtëm që shkalla e mos-përgjigjeve në këtë pyetje është mjaft e lartë, që është dëshmi/tregues i vështirësisë për të gjykuar këtë pikë.



## 5. Qëndrimet ndaj shumëllojshmërisë

QE6 Duke përdorur notën prej 1 deri në 10, ju lutem më tregoni si do ndiheni nëse përfaqësuesi më lart i zgjedhur politik vjen nga këto grupe në (SHTETIN JONË)?


Përgjigje: Vlera mesatare



Maqedonasit treguan një rezervë/heshtje kur kërkohet të imagjinojnë një lider politik të zgjedhur në zyrën më të lartë kombëtare dhe që do mund të jetë i/e moshës mbi 75 vjeç, të jetë homoseksual apo person me aftësi të kufizuara fizike. Rezultatet mesatare të marra në këtë vend janë shumë më të ulëta se ato të vëzhguara në Bashkimin Evropian. Vetëm prospekti i një personaliteti politikë femër, apo të fesë tjetër, përkatësisë etnike të ndryshme ose nën moshë 30 vjeç mori një përgjigje të shumicës.

## 6. Lufta me diskriminimin

QE10 A i njihni të drejtat e juaja në qoftë se jeni të diskriminuar ose të malltretuar?



■ Gjithsej Po ■ Gjithsej Jo ■ Nuk e din ■ Mvaret (NUK LEXOHE)  
BE27 I jashtëm MK I brendëshme

Gati një Maqedonas nga dy thotë se ata i njohin të drejtat e tyre nëse ata kanë qenë viktimë e diskriminimit apo ngacmimit. Është 12 pikë më mirë se sa në nivel Evropian. Duke thënë këtë, pothuajse aq shumë vuajnë nga mungesa e informacionit në këtë pikë.  
Femrat, njerëzit e moshës mbi 55 vjeç dhe njerëzit që kanë ndalur studimet më herët, kuptohen si popullatë me më shumë gjasa të jenë subjekt i një diskriminimi të tillë, dhe duket të jenë më pak të vetëdijshëm për të drejtat e tyre.


Persona me origjin etnike tjetër nga e juaja

Po %	BE27	MK
Gjithsej	33%	45%
Gjinia		
Mashkull	35%	47%
Femër	31%	43%
Moshën		
15-24	34%	52%
25-39	37%	48%
40-54	36%	48%
55 +	27%	33%
Arsimi (nga fundi i)		
15-	21%	32%
16-19	33%	47%
20+	44%	56%
Akoma studion	33%	58%




## 6. Lufta me diskriminimin

QE9 Në përgjithësi, a do të kishit thënë se mjaft është bërë (SHTETIN JONË) për tu luftar kundër të gjith formave të diskriminimit?



Maqedonasit janë po aq të ndarë sa edhe Evropianët kur përpilojnë një listë të përpjekjeve të bëra në vendin e tyre për të luftuar të gjitha format e diskriminimit. Ka një shumicë relative të vogël që është duke menduar se këto përpjekje janë të mjaftueshme, por pothuajse aq shumë mendojnë të kundërtën.

QE15T Nëse jeni viktimë e diskriminimit ose jeni të maltretuar, kujt do të kishit preferuar ti ja raportoni rastin? Së pari? Dhe pastaj? Dhe përfundimisht?



\* Emri specifik i dhënë në secilin shtet

Ashtu si Evropianët si një tërësi, Maqedonasit, në qoftë se do të ishin viktimë të diskriminimit apo ngacmimit, në vend të parë do të kthehet drejt policisë, pastaj një avokati ose në gjykatë. Por ndërsa një e treta e Evropianëve do t'i paraqitej një organizate për mundësi të barabarta, vetëm 24% në IRJM do të bënte të njëjtën (11 pikë më pak se sa në nivel Evropian) do preferonin të jenë ndihmuar nga një OJQ ose një shoqatë.

